



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS

Nr. _____ prot

Durrës, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Siguracione Automjetesh”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):
66514110-0**

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-82380-04-17-2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.492.400 (Një milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e katërqind e)lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik te paraqese Liçense profesionale te leshuar nga Autoriteti Mbikqyres Financiar per kryerjen e aktivitetit ne fushen e Sigurimeve ku perfshihet dhe Sigurimi i Automjeteve.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me Ligji nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", konkretisht nenin 6 dhe nenin 9 të tij, të cilat përcaktojnë se veprimtaria e sigurimit ushtrohet vetëm nga shoqëri të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe se ushtrimi i kësaj veprimtarie pa licencën përkatëse është i ndaluar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Në këtë kuadër, kërkesa për paraqitjen e licencës garanton që operatorët ekonomikë janë të autorizuar ligjërisht për të ofruar sigurimin e automjeteve dhe plotësojnë standardet rregullatore dhe financiare të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 4 e nenit 55 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, perkatesisht; Pika 4 : *Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave*; Autoriteti Kontraktor duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë, rëndësinë e objektit të prokurimit për mbarëvajtjen e punës si dhe hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, si edhe bazuar në ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi **për shërbime** të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit dhe fatura tatimore të shitjes, të **plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit** në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të **plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata shërbimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të shërbimit objekt prokurimi për mbarëvajtjen e punës, i rëndësishëm për kryerjen e detyrave funksionale të

trupës së Prokurorisë së Posaçme, me qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.

2.3.2 Mjetet me targe **AB221JL, AB813VD**, përveç policës së sigurimit të detyrueshme, duhet të pajisen dhe me policën Kasko, duke qene te vitit te fundit prodhimi dhe sherbejne per mirembajtjen sa me te mire te tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 1, neni 77, Kreu XI të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 4/a), neni 41, Kreu V të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Ligjit Nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (i ndryshuar) si dhe në nenin 28, Kreu III të Ligjit Nr.52, date 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Vendosja e këtij kriteri synon mbrojtjen e interesit publik, duke garantuar mbulim të plotë të riskut për mjetet e institucionit, të cilat janë pasuri publike me vlerë të konsiderueshme, si dhe minimizimin e dëmeve financiare në rast aksidenti apo dëmtimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Siguracion TPL

Në kuadër të ligjit Nr.32, datë 16.03.2021 ”Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (i ndryshuar) çdo automjet që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jetë i pajisur me policën TPL (Sigurimi i Detyrueshëm i Mbajtësit të Mjetit Motorik për Përgjegjësinë Civile ndaj Palëve të Treta).

Përmes këtij produkti, shoqëritë e Sigurimeve mbulojnë përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, në përputhje të plotë me parashikimin e Ligjit.

Ky sigurim përfshin mbulimin e shpenzimeve si pasojë e dëmeve materiale dhe shëndetësore të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit motorik të siguruar.

Primi i sigurimit është 1-vjeçar.

Siguracion KASKO

Përmes policës së sigurimit të vetë mjetit motorik KASKO, shoqëritë e Sigurimeve ofrojnë mbulimet në sigurim lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të mjetit motorik të siguar si rezultat i rreziqeve të ndryshme.

Përmes këtij sigurimi mbulohen:

- (h) Dëmtimet aksidentale: përplasja e automjetit me një objekt fiks ose të lëvizshëm, përmbysja e mjetit motorik;
- (i) Thyerja e xhamave: thyerja e xhamave të përparmë, të pasmë, anësorë, të tavaneve të hapur, shkaktuar këto nga goditja e një objekti të lëvizshëm;
- (j) Zjarri, rrufeja, eksplozioni: dëmet e shkaktuara nga zjarri, eksplozioni dhe rrufeja;
- (k) Katastrofa natyrore: dëmet e shkaktuara nga stuhia, breshëri, dëbora, tufani, përmbytja, vërshimi dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorik nga rënia e objekteve të ndryshme që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore;
- (l) Dëmtime në parkim (pa autor): dëmet që pëson mjete motorik gjatë qëndrimit i parkuar diku dhe nuk dihet shkaktari i dëmit.

1. Në rast aksidenti të ndodhur në mjet gjatë periudhës të sigurimit, shoqëria e sigurimeve e quajtur kontraktues, të marrë përsipër riparimin e mjetit deri në kthimin e tij në gjendjen e mëparshme në një nga serviset e autorizuara prej saj.

2. Dorëzimi dhe marrja e mjetit para dhe pas riparimit pranë servisit të autorizuar të bëhet në prani të përfaqësuesve të operatorit ekonomik dhe të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor.

Primi i sigurimit është 1-vjeçar.

Lista e mjeteve me targat si më poshtë:

NR	TARGA	TIPI	VITI I PRODHIMIT	MARKA	KAPACITETI MBAJTES KG
1	AB 014 HN	AGREGAT	2012	IVECO FIAT	15650
2	AB 835 HL	AGREGAT	2013	IVECO	11000
3	AB 847 HH	AGREGAT	2011	IVECO	10600
4	AB 892 HH	AGREGAT	2011	IVECO	15100
5	AA 158 UI	AGREGAT	2005	IVECO MAGIRUS	13850
6	AA 076 YM	AGREGAT	2008	DAF	16625
7	AA 658 SI	AGREGAT	2001	SCANIA	15340
8	DR 51-30 C	AGREGAT	1988	BERCEDES BENZ	8000
9	DR 82-63 A	KAMION	1993	IVECO	5000
10	AA 316 UM	KAMION	2007	IVECO FIAT	4700
11	DR 69-64 E	KAMION	1991	IVECO FIAT	13335

12	DR 76-39 C	KAMION	1984	DAIMLER BENZ	12540
13	DR 83-41 A	KAMION	1990	IVECO FIAT	8000
14	AA 299 MX	KAMION	2000	MAN	13750
15	DR 85-08 A	KAMIONCINE	1987	IVECO	6500
16	DR 87-09 C	KAMIONCINE	1981	FORD	1700
17	DR 72-43 D	KAMIONCINE	1987	MERCEDES BENZ	7500
18	AA 726 RZ	KAMIONCINE	2003	NISSAN	3860
19	AA 693 OM	KAMIONCINE	2002	FORD	3500
20	AB 349 IR	KAMIONCINE	2015	NISSAN	4500
21	AB 974 IP	KAMIONCINE	2014	IVECO	3500
22	AB 970 IP	KAMIONCINE	2014	IVECO	3500
23	MOTOKARRO	MOTOKARRO	1997	APE 703	800
24	DR 81-58 A	AUTOBOT	1994	IVECO FIAT	10000
25	DR 81-57 A	AUTOBOT	1991	IVECO FIAT	10000
26	AB 221 JL	AUTOBOT	2008	ISUS	5000
27	DR 798 C	MOTOKARRO	2003	SHIFENG	1000
28	DR 69-67 E	FADROME	1996	FIAT	5950
29	DR 63-14 D	FADROME	1996	FAI	8150
30	AM MT 29	AUTOFSHESE	2020	BUCHER	2950
31	AM MT 30	AUTOFSHESE	2008	SICAS EUROCLEN	5600
32	DR 69-65 E	ESKAVATOR	1996	ORNESTAIN KOPPEL	4000
33	AB 988 IP	FUORISTRAD	2016	SSANG YONG	4+1
34	AA 166 IX	AUTOVETURE	1999	MERCEDES BENZ	4+1
35	AB813VD	FUORISTRAD	2025	FOTON	4+1
36	AB460XU	AGREGAT	2008	DAF	15650
37	AB459XU	AGREGAT	2008	DAF	3500
38	AA766MK	AUTOVETURE	2001	BMW	4+1
39	CA896KX	Furgon	2001	IVEKO DAILY	1500

Policat e sigurimit duhet te jene me afat 1 vjecar per cdo mjet.

Datat e fillimit te policave dhe kopje te librezave perkatese te mjeteve do t'iu vihen ne dispozicion operatorit ekonomik ditën e shpalljes se fituesit, dhe cdo police do te hyje ne fuqi ne momentin e mbarimit te polices ekzistuese.

Mjetet, brenda kushteve teknike, te cilet duhet te pajisen me police sigurimi jane 39 (tridhjetë e kater).

Mjetet me targe **AB221JL**, **AB813VD**, pervec polices se sigurimit te detyrueshme, duhet te pajisen dhe me policen Kasko, duke qene te vitit te fundit prodhimi dhe sherbejne per mirembajtjen sa me te mire te tyre.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Specifikimet teknike për shërbimin objekt prokurimi janë hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, në përputhje me nenin 4 pika 38/b dhe nenin 36 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 40 pika 2 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike janë konceptuar duke përshkruar minimumin e kërkesave funksionale dhe të mbulimit të sigurimit që duhet të ofrohen nga operatori ekonomik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së plotë të mjeteve motorike të institucionit dhe minimizimin e riskut financiar në rast aksidenti, dëmtimi apo humbjeje.

Kërkesat janë përcaktuar në bazë të nevojave reale të autoritetit kontraktor, duke marrë në konsideratë përdorimin intensiv të mjeteve dhe rëndësinë e garantimit të vijueshmërisë së shërbimit publik. Në këtë kuadër, kushtet e policave të sigurimit janë orientuar drejt ofrimit të mbulimit të plotë dhe të besueshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi për veprimtarinë e sigurimeve.